



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assamby of Hani Elezit

01/ Nr. 902/2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, neni 17 nënparagrafi (k), neni 40, (të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 28/2008), Statutin e Komunës neni 6 nënparagrafi (I) , Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 15, Shkresës së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me numër nr.506 të datës 25.01.2012, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më datë 23.02.2012 mori:

V E N D I M

PËR PËRCAKTIMIN E PARCELËS PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË QPS-së

I

Miratohet propozim vendimi me numër 07/Nr.902/2012 për përcaktimin dhe ndarjen e parcelës për ndërtimin e Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Hanit të Elezit, e cila gjendet në zonën kadastrale Hani i Elezit, parcela me numër nr.151-1 në pronësi të Komunës së Hanit të Elezit.

II

Në bazë të shkresës së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me numër nr.506 të datës 25.01.2012, jemi njoftuar për ndërtimin e Qendrës për Punë Sociale të cilët kanë kërkuar që të bëhet përcaktimi i parcelës për ndërtim të kësaj qendre..

III

Komuna e Hanit të Elezit në mungesë të pronave të tjera më të përshtatshme komunale ka vendosur që të bëjë përcaktimin në parcelën me numër 151-1 për ndërtimin e këtij objekti.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

V

Më këtë Vendim njoftohen: Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit:
Data: 24.02.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlashi

